

Mr. Haki Kasumi

**QËNDRIMI I BASHKËSISË FETARE ISLAME
NDAJ LËVIZJES NACIONALÇLIRIMTARE NË KOSOVË
(1941—1945)**

Fronti popullor dhe PKJ, duke u nisur nga mësimet e marksizmit mbi religjionin, nga rëndësia shoqërore e religjionit dhe veprimtarisë së kishës, nga karakteri i lidhmërisë së bashkësive fetare me shtresën borgjeze të Jugosllavisë së Vjetër, si dhe nga kushtet ekzistuese klasore qysh para luftës, më 1937, në kuadër të konceptit të përgjithshëm revolucionar, u deklaruan për ndarjen e fesë nga shteti. Parimet e një zgjidhjeje dhe të një qëndrimi të tillë të fesë ndaj shoqërisë i përmbante edhe platforma programore e frontit Popullor të vitit 1937, ku, po ashtu, kërkohesh ndarja e fesë nga shteti dhe u bëhej thirrje të gjithë atdhetarëve që, pa marrë parasysh bindjet politike, kombëtare, fetare e të tjera, të hedhen në luftë të përbashkët kundër fashizmit. Parimet e tilla i hasim edhe në fjalimin e Titos më 1937, ku thuhet: „Ta lëmë tash për tash anash diskutimin rreth parajsit qiellor, të luftojmë së bashku me ata që janë fetarë, kundër ferrit në tokë, ferrit, flaka e të cilit po i përfshin njësoj teistët dhe ateistët. Në mënyrë që t’ua lehtësojmë atyre të bashkohen në frontin e paqes, të lirisë dhe të përparimit, ne duhet të ndalojmë gjithë atë që do të ofendonte ndjenjat e tyre fetare”.¹

Linja kryesore e veprimtarisë së Bashkësisë Fetare Islame — BFI-së, pos në punët fetare, mbështetej edhe në dëgjueshmërinë dhe zbatimin e politikës së borgjezisë që ishte në pushtet

Gjatë vitit 1940 nëpunësit e BFI-së në Kosovë u njoftuan mbi gjendjen politike në vend dhe në botë. Reis-ul-ulemaja me shkresën e tij u bënte apel të gjithë myslimanëve (këtu mendohet për numrin e gjithmbarshëm të banorëve të besimit islam në Jugosllavi) që ta ruanin kompaktësinë e tyre duke thënë: „Më tepër se kurdoherë në këto momente është i nevojshëm bashkëpunimi i sigurtë si dhe dashuria vëllazërore ndërmjet të gjithë qytetarëve pa marrë parasysh dallimet kombëtare dhe fetare. Është e nevojshme të jemi të disiplinuar si dhe t’u nënshtrohemi të gjithë urdhërave të organeve tona shtetërore, të cilat kanë për qëllim të mbajnë rend brenda vendit me qëndrim neutral ndaj ngjarjeve

¹ Josip Broz Tito, *Govori i članci, I*, Naprijed, Zagreb, 1959, 63.

të jashtme. Kështu kërkojnë interesat momentale të vendit”.² Lidhur me këtë gjatë këtij viti në të gjitha komisionet e vakufeve mearife arrijnë shkresat me porosi që të ndërtoheshin strehimore mbrojtëse prej sulmeve të armikut. Përkundër inisimit, „deri në prill të vitit 1941 nuk ishte ndërmarrë asgjë”.³ Për këtë arsye organet e BFI-së në Kosovë urdhërohen: „të mbanin ceremoni fetare (vajze) nëpër objektet e tyre fetare lidhur me aktin e nënshkrimit të Paktit Trepalësh”.⁴ Pos të tjerash, nëpunësit fetarë duhej ta arsyetonin në mënyrë bindëse aktin kapitullues të qeverisë para masave të popullit. Me siguri edhe ky ishte një prej faktorëve pse në demonstratat e marsit të vitit 1941 masat shqiptare s’qenë përfshirë në to në mënyrë të gjerë.⁵

Imamët shtetërorë i ndihmuan pushtetit borgjez edhe me rastin e përgatitjes për „mobilizim të përgjithshëm”, i cili u shpall më 7 prill. Imamët ofiqarë përpilonin listat me shënime për „meshkujt e lindur në vitet 1921—1923, të cilat duhej t’i dorzonin në organet komunale të vendit më së largu deri më 5 janar të vitit 1941”.⁶

Qëndrimi i BFI-së ndaj aktit të nënshkrimit të kapitullimit të vendit ishte proborgjez. Një gjë e tillë shihet nga shkresa nr. 61 e prillit të vitit 1941, në të cilën naçallnikët e rretheve urdhëronin që nëpunësit fetarë të njoftonin popullin nëpër objekte fetare dhe më gjerë për:

- „1. Lidhjen e marrëveshjes ndërmjet shtetit dhe armikut,
2. Që menjëherë të normalizohej gjendja në vend. . .

Pasi më nuk ekziston frika nga sulmet prej armikut, si dhe çfarëdo shqetësimi tjetër, armikut vetëm i është lejuar të transportojë trupat nëpër vendin tonë për në Lindje”.⁷

Përkundër qëndrimit kapitullues të organeve të pushtetit borgjez dhe të bashkësive fetare, PKJ qysh në luftën e prillit të vitit 1941 ishte orientuar në organizimin e luftës çlirimtare kundër pushtuesit dhe bashkëpunëtorëve të tij. Kjo shihet në Proklamatën e KQ të PKJ të 15 prillit 1941 kur bëhej apel për vazhdimin e rezistencës kundër agresorit. KQ i PKJ-së theksonte se komunistët dhe klasa punëtore e Jugosllavisë do të jenë „në radhët e para të luftës së popullit kundër pushtuesit dhe se do të qëndrojnë në këtë luftë deri në fitoren përfundimtare”. Në këtë Proklamatë vihej në dukje domethënia shoqërore-politike e luftës në të cilën „ka për të lindur një botë e re” dhe se do të formohej „Bashkësia e lirë vëllazërore me pavarësinë e vërtetë të të gjithë popujve të Jugosllavisë”.⁸

Për të siguruar suksesin e kësaj lufte, në Këshillimin e PKJ, që u bë në Zagreb më 4 maj 1941, pos të tjerash, iu dha detyrë direkte Partisë të „tubonte të gjitha shtresat e popullit, pa marrë

² AK, V. O. Prištine, D. 54/40 (fond i parregulluar).

³ AK, V. O. Prizren, L-III, K-16-2/1940.

⁴ AK, V. O. Djakovica, L. IV-K. 5-52/41, D. 432.

⁵ *Mitrovica dhe rrethina (monografi)*, Mitrovicë, 1979, 251.

⁶ AK, V. O. Djakovica, D. 15418/40 (fond i parregulluar).

⁷ AK, V. O. Djakovica, L. IV. K-5, D. 43/41.

⁸ Si shënimi 6.

parasysh diferencat politike, fetare, kombëtare e të tjera, në një front unik të luftës kundër pushtuesit dhe bashkëpunëtorëve të tij, dhe konstatoi se PKJ ishte e aftë në pikëpamje ideore dhe organizative të merrte mbi vete kryerjen e kësaj detyre historike, sepse e kishte ruajtur unitetin e vet dhe kishte vepruar si fuqi politike e përgjithshme jugosllave, megjithëse pushtuesi e ka coptuar vendin dhe ka vënë shumë kufij në mes të zonave pushtuese”⁹.

Pas kapitulimit të Jugosllavisë monarkiste, Kosovën e pushuan dhe e coptuan pushtuesit gjermanë, italianë dhe bullgarë. „Pjesa më e madhe e kësaj treve mbeti nën pushtetin e Italisë dhe iu aneksua „Shqipërisë së Madhe” në gusht të vitit 1941. Nën pushtimin bullgar mbetën: një pjesë e rrethit të Gjilanit në veri të Pasjanit, një pjesë e rajonit të Vitisë, të Kaçanikut dhe të rrafshit të Siriniqit. Zonës pushtuese gjermane i takuan tri rrethe: i Mitrovicës, i Vuçitërnës dhe i Llapit (Podujevës)”¹⁰.

Me ndarjen e lartpërmendur u bë edhe ndarja e re administrative e BFI-së, në atë mënyrë që zona që ishte në kuadër të „Shqipërisë së Madhe”, pra ajo nën okupimin Italianë, u lidh me kryeqendrën e re në Tiranë, ku ekzistonte Kryesia e Këshillit të Ylemave të Komunitetit Mysliman.¹¹ Përfaqësues të BFI-së nga Kosova në Tiranë u dërguan hafëz Bedri Hamiti dhe hafëz Sherif Langu, që të dy më parë ishin anëtarë të Ulema Mexhllisit të Shkupit.¹²

Në zonën okupuese bullgare organizimi i BFI-së mbeti i pa ndryshuar, pos themelimit të qendrës së re në Shkup, nga pastaj lidhej me qendrën e Myftinisë Supreme në Sofje. Ndërkaq, në pjesët e Kosovës që hynë nën okupimin gjerman, përkatësisht nga viti 1942 në kuadër të Serbisë së Nediqit, organet e BFI-së së këtyre viseve ishin të lidhur me kryeqendrën e formuar në Novi Pazar, që lidhej me Beograd”.¹³ Edhe rregullimi i brendshëm administrativ i BFI-së u ndryshua pjesërisht. Në viset e zonës okupuese italiane u ripërtërin myftinitë. Në Kosovë u formuan dy zona të kryemyftinive. Në qendrat e kësaj zone ekzistonin myftinitë, ndërsa në vendbanimet më të vogla nënmyftinitë.

Kryemyftinia e zonës së Prizrenit përfshinte zyrat e vakufëve: në Gjakovë, Suharekë, Rahovec dhe në Dragash, ndërsa Kryemyftinia e zonës së Prishtinës përfshinte zyrat e vakufëve: në Gjilan, Drenicë (Skenderaj) dhe në Ferizaj. Peja, për mungesë të buxhetit që të bëhej kryemyftini mbetët myftini, por korrespondon direkt me kryesinë e Këshillit të Ulemave në Tiranë. Ajo sikurse edhe kryemyftinitë e tjera, ishte e ngarkuar me të njëjtat detyra e të drejta dhe përfshinte zyrat e vakufëve: në Istog, Plavë e Gusi, Rozhajë dhe në Tutin. Në këtë kohë edhe në Dibër të Madhe u formua një kryemyftini që përfshinte zyrat e vakufëve: në Gostivar, Tetovë, Kërçovë, Rekë (Rostushë) dhe në Strugë.¹⁴

⁹ *Po aty*.

¹⁰ Si shënimi, 2, 11.

¹¹ Kujtim i shënuar në terren, 24. IV. 1980, Frishtinë.

¹² *Po aty*.

¹³ *Po aty*.

¹⁴ AK. V. O. Prištine, D. 43, (fond i parregulluar).

Marrë në përgjithësi, BFI-a, edhe pse u nda në tri qendra, në thelb vepronte njësoj por ndryshonte vetëm për nga forma. Veçohet personeli i BFI-së që vepronte në kuadër të „Shqipërisë së Madhe”, ku parullës së tyre fetare në këtë kohë ia bashkuan edhe atë atdhetare (nacionaliste — H. K.), siç thuhet në dokumentet e kohës: „Imamët ofiçarë (shtetërorë) do të qëndrojnë kurdoherë në krye të detyrës që u është ngarkuar dhe njëkohësisht do të japin vaize (këshilla) fetare dhe atdhetare pasi është gjetur nevoja e kësaj kryemyftinie”.¹⁵ Gjatë kësaj periudhe u bë edhe riemërimi i imamëve. Dekretet e emërtimit iu lëshoheshin nga kryeqendrat përkatëse. Imamët ndaheshin në dy kategori, në shtetërore dhe privatë. Meqë imamët shtetërorë paguheshin me rroga të larta, p.sh., imami shtetëror në zonën okupuese italiane merrte 600 lekë, vajzi 400, mësuesi i besimit 500, muezini 400¹⁶ etj., ishin mjaft aktivë.

Ideologët myslimanë shqiptarë më parë kërkonin ta njësonin islamizmin me socializmin, kurse në vitet e pushtimit e gjetën ideologjinë e tyre të njëjtë me fashizmin. Kështu kryetari i Komunitetit mysliman, Bexhet Shapati botoi në ato vite një broshurë, ku vinte vijën e barzimit ndërmjet islamizmit, fashizmit e nacional-socializmit. Pikëpamjet e Bexhet Shapatit dhe të myftiut të Prishtinës lidhur me këto çështje i mbanin isan propagandës fashiste në Shqipëri e në vendet e tjera”.¹⁷

Në Kosovë okupatori arriti të përfitonte një numër të konsiderueshëm klerikësh në shërbim të vet, ashtu si kishte ngjarë edhe në viset e tjera të vendit. „Këtë pjesë të tyre e përbënin kryesisht karrieristët e ndryshëm, të cilët kishin karakter labil dhe ambicie të sëmura, pra, që ishin të gatshëm për tradhti. Të gjithë ata që u vunë në shërbim të okupatorit, luftonin kundër vëllazërim-bashkimit të popujve, përhapnin urrejtjen shoviniste dhe nacionaliste, mbillnin mosbesim dhe përçarje të iltarët e tyre, i bënin thirrje popullit për luftë kundër Partisë Komuniste, Luftës Nacionalçlirimtare dhe Revolucionit. Klerikët e tillë e keqpërdorin fenë dhe institucionet e saj për qëllime të tyre tradhtarë”.¹⁸ Në dokumentet e kohës shihet qartë qëndrimi i BFI-së ndaj Partisë Komuniste dhe LNÇ-së në Kosovë. „Asht e ditun edhe prej anës s’uaj, se goftë kleri dhe goftë streha e tyre¹⁹ që frymzohen ata, janë të influencuem me ndjenja nacionaliste dhe patriotike gjatë të cilat janë tuj përhapun gjithë, tue i pri atë në çdo vepër Atdhetarie. Ashtë e kjarhtë se këto strehna janë tue përgadit personelin që u ven ballë vet dhe tërheqin gjithë popullin kundra „komunizmit barbar” dhe çdo ndjenje tjetër shkatërruese për Atdheun t’onë të dashun”,²⁰ shkruan kryemyftiu i zonës së Prishtinës. Kjo shkru-

¹⁵ AK, V. O. Prištine, D. 10/43 (fond i parregulluar).

¹⁶ AK, V. O. Prištine, lista e rrogave të nëpunësve fetarë.

¹⁷ V i r o n K o k a, *Ideologjia reaksionare e klerit në vitet '30 të shek. XX*, Studime Historike, 3, 1968, Tiranë, 75.

¹⁸ Nikola P. Ilić, *Sveštenstvo Južne Srbije u revoluciji 1941—1945*, Leskoc, 1972, 173.

¹⁹ Nxënësit e shkollave fetare.

²⁰ AK, V. O. Prishtine, D. 570. (fondi i parregulluar).

së vazhdon duke theksuar gatishmërinë e klerikëve: „Shtojmë se në rast nevoje ma të ngushta do të jemi gadi gjith kleri, pa asnjë përjashtim të kryejmë detyrën t'onë të shejtë kundër Atdheut”.²¹

Qëndrimi besnik ndaj pushtuesve italian i pjesës më të madhe të nëpunësve të kësaj bashkësie fetare vazhdoi deri në ditët e fundit të sundimit të tyre.

Më 8 shtator të vitit 1943 Italia fashiste kapitulloi pa kushte. Të gjithë popujt liridashës e pritën me gëzim këtë fitore të aleatëve. Por, lufta ende nuk kishte mbaruar dhe vendin e pushtuesve fashistë italianë e zuri ushtria gjermane.

Pushtuesi gjerman kërkonte të përdorte metoda të tjera nga ato që përdoren italianët. Në këtë drejtim invaduesit e rinj përqeshin që me metoda demagogjike t'i mashtrojnë masat popullore, duke u premtuar atyre „sigurim e pavarësisë”, dhe t'i bindnin të hiqnin dorë nga LNÇ ngase rajhu gjerman do t'i siguronte lirinë popullit shqiptar. Por pjesa dërmuese e popullit këto premtime demagogjike i hodhi poshtë dhe vazhdoi të përkrahte komunistët dhe LNÇ, ndërsa një pjesë tjetër, që përbëhej nga tradhtarët e ngjyrave të ndryshme, menjëherë u vu në shërbim të pushtuesve të rinj gjermanë. Këtë grup e përbënin, pos të tjerëve, edhe një pjesë e klerikëve të të tri konfesionëve. Lidhur me këtë regjimi i armikut theksonte: „Një ndër klasat shoqërore të Shqipërisë (mendohet për Shqipërinë e Madhe) ku rezhimi mund të mbështetet në ndihmën morale për ti ba ballë smundjes bolshevike, duhet ditë se është kleri i të tri besimeve...”.²²

Kështu, konkretisht në rastin e propagandës së pushtuesve gjermanë kundër sistemit pushtues italian, të cilin e akuzonin pas kapitullimit thuhej: „Sikurse dihet, veprimet luftarake dhe okupacioni italian, kanë pasë për konsekuencë mjerimin absolut të popullsisë...”.²³ Lidhur me këtë urdhërohen organet fetare që: „me anë të hoxhaliarëve, tue predikue në xhami ose në mbledhjet e tyre, të bëhet një propagandë në favor të mjerimeve nga okupatori italian”.²⁴ Në këtë drejtim pushtuesit e rinj para BFI-së paraqiteshin si „çlirues të vërtetë” nga pushtuesit italianë, të cilët e favorizonin vetëm bashkësinë fetare katolike. Për ta arsyetuar këtë, pushtuesit gjermanë që nga ditët e para të vendosjes të sistemit të tyre u angazhuan për përmirësimin e pozitës së përgjithshme të nëpunësve të BFI-së. Në këtë mënyrë ata propozonin reforma të rregullimit administrativ të kësaj bashkësie fetare (e në të vërtetë nuk u bë asgjë në këtë plan pos që u zgjeruan kompetencat e nëpunësve fetarë në zonat e kryemyftinive, rregullimit të statusit të nëpunësve fetarë (sipas së cilës të gjithë nëpunësit fetarë, qofshin shtetëror ose privatë, obligoheshin të posedonin dekreten e emërimit nga kryeqendra në Tiranë). Brenda një kohe të shkurtër një numër i konsideruar i nëpunësve të BFI-së mori dekretet e emërimit pas betimeve që bënin. Nga vetë akti i betimit

²¹ *Po aty.*

²² *Studime historike*, nr. 2, Tiranë, 1968, 193.

²³ *AK*, V. O. Prištine, D. 35822, 2 dhjetor 1943.

²⁴ *Po aty.*

të nëpunësve fetarë mund të shihen kompetencat e mëdha të vepërimeve të tyre. Për ilustrim të kësaj që thamë po citojmë një akt të betimit të tyre:

„Betohem në emen të perëndisë
se do të jam besnik i shtetit Shqiptar
i statutit, i atdheut e se do të kryej
detyrën t'eme me ndërgjegjëje të pastër,
kombëtare, tue ruejt besnikrin kundër urdhnave
fetare dhe tue respektue plotsisht statutin e
gjith rregulloret e komunitetit”²⁵

Që të rritet ndikimi i BFI-së në masat e varfëra, pushteti jepte ndihma materiale në ndarjen e bukës dhe të miellit nëpërmjet organeve të kësaj bashkësie fetare. Kështu, „vakëfi Bejtullah Aga e H. Adilit ndau 405 kg miell për të vobektit (një kilogram miell kushtonte 1,60 franga shqiptar) në muajin nëntor të vitit 1943”²⁶ Ky aksion vazhdoi gadi në të gjitha vakëfet e Prishtinës prej nga u shpërndan sasi të mëdha të miellit dhe bukë të furrës për të vobektit.²⁷ Shpenzimet llogaritur në të holla kapnin shumën prej 4002.40 fr/shq.²⁸ Këto aksione humanitare me prapavijë politike nuk mbetën pa ndikim e që manifestohej nëpërmjet afrimit dhe të lidhjes së masave për bashkësitë fetare. Ishte kjo një përpjekje e përgjithshme drejt nënshtrimit sa më të madh të masave, së pari BFI-së e pastaj nëpërmjet saj t'i përkuleshin pushtetëmbajtësve kuislingë, të cilët, siç dihet, ishin shërbëtorë të pushtuesit.

Sukseset gjithnjë e më të mëdha të koalicionit antihitlerian dhe të lëvizjeve nacionalçlirimtare të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë ndikuan pozitivisht në formimin e disponimit antifashist të masave në Kosovë.²⁹ Në këtë drejtim aktiviteti i komunistëve dha kontribut të madh. Lidhur me këtë bëhet fjalë në Rezolutën e Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë e Metohi, të nëntorit të vitit 1943; „Situata në Frontin Lindor, bombardimi i përhershëm i prapavijës gjermane dhe gjendja në Itali dhe në vendet e tjera të robëruara, e sidomos në Ballkan, demaskojnë parullat për pathyeshmërinë e nazizmit, përkatësisht të gjitha këto e kanë ndryshuar disponimin e popullit në Kosovë...”³⁰

Rezultatet e deriatëhershme të LNÇ-së ishin pa dyshim kontribut i punës së organizuar mirë të Partisë. Partia për herë u bënte thirrje të gjithë atdhetarëve për luftë kundër okupatorit. Thirrjet e tilla u përgjigjeshin, pos të tjerëve, në disa raste edhe klerikët myslimanë, numri i të cilëve nuk ishte i madh. Detyrat me të cilat ngarkoheshin ata ishin: Mbajtja e lidhjeve ndërmjet çelulave të komunistëve dhe ta njoftonin popullin në mënyrë të drejtë mbi qëllimet e mira të LNÇ-së etj.

²⁵ AK, V. O. Prištine, D. 9/7, (fond i parregulluar).

²⁶ AK, V. U, Prištine, D. 321, (fond i parregulluar).

²⁷ AK, V-U, Prištine, D. 425, (fond i parregulluar).

²⁸ Po aty.

²⁹ Si shënimi 6.

³⁰ Po aty; AVII. D. 202.

Në të vërtetë, klerikët myslimanë ua shpjegonin besimtarëve të vet se partizanët dhe komunistët nuk janë rrënues të objekteve fetare, si propagandonin shërbëtorët e ndryshëm të armikut. Po ashtu ata theksonin se partizanët i respektojnë dhe luftojnë edhe për lirinë fetare dhe zakonore. Në prapavijë, kjo kategori e klerikëve vepronte në mënyrë aktive në dobi të LNÇ-së, pastaj kujdesej për të plagosurit, përkrahte dhe punonte në formimin dhe në mirëvajtjen e punës së këshillave nacionalçlirimtare. Kështu, nuk ishin të rralla rastet kur anëtarë të organeve të para të pushtetit popullor zgjidheshin edhe nëpunësit e BFI-së (sidomos imamët).³¹

Gjatë kësaj periudhe një pjesë e klerikëve vazhdoi të mbante qëndrim neutral. Këta nuk bashkëpunonin as me okupatorët dhe bashkëpunëtorët e tij dhe as me LNÇ-në. Kjo kategori e klerikëve vepronte në mënyrën e vet, kryesisht në kryerjen e detyrave fetare dhe përpiqej të mos lëshohen në kurrfarë analizash të gjendjes politike në të cilin ndodhej vendi në atë kohë.

Bashkësitë fetare i godiste rëndë revolucioni i ynë socialist e jo aq LNÇ-ja.³² Ky konstatim rezulton nga qëndrimi i PKJ-së, sipas së cilit kisha dhe feja duhej të ndaheshin nga shteti. Këtë qëndrim marksist e parimor e përdornin okupatori dhe bashkëpunëtorët e tij për të zhvilluar propagandë kundër LNÇ-së dhe revolucionit në Jugosllavi, pra edhe në Kosovë. Propaganduesit e tillë mbillnin pakënaqësi në mesin e klerikëve dhe të besimtarëve duke bërë thirrje për bojkotim të LNÇ-së, pastaj kërkonin prej tyre që të hidheshin edhe në luftë të hapët së bashku me armikun kundër LNÇ-së.³³

Çështja e religjionit, e fesë dhe e kishës për PKJ-në në këtë kohë konsiderohej si çështje politike. Për këtë arsye gjatë luftës dhe revolucionit veprime me kujdes në këtë drejtim duke pasur parasysh që të mos ashpërsoheshin marrëdhëniet me të. Në këtë drejtim Partia angazhohej në mënyrë të posaçme dhe planifikonte që kjo çështje të zgjidhej gradualisht. Gjatë LNÇ-së luftëtarët dhe udhëheqësit e tyre, pastaj anëtarët e PKJ-së dhe të BRKJ-së formonin dhe forconin qëndrimin dhe bindjet e tyre marksiste ndaj religjionit, por gjithmonë kishin parasysh situatën reale dhe qëllimin e përfitimt të masave. Këta vepronin në shumë raste edhe jashtë vijës së Partisë. Kështu, nëpër shtëpitë e fshatarëve vepronin sipas zakoneve dhe adeteve të tyre fetare. „Kremta fetare të bëhet sipas traditës, zbashku me organet e pushtetit popullor. Për këtë ushtrisë t'i ipet ushqim më i mirë”.³⁴ Porositë e tilla nga organet e larta ushtarake dhe partiake ushtronin ndikim dhe lenin përshtypje të mirë në popull. Ndaj klerikëve veprime me maturi të posaçme, kështu që në rast të ndonjë gabimi, atyre u tërhiqej vërejtja interne, ndërsa për gabime të rënda likuidohe-

³¹ *Shënim nga terreni*, Prishtinë, 1979.

³² Si shënimi 19, 7.

³³ *Po aty*, 9.

³⁴ AVII, 21/7, K. 1452 (Urdhër i Shtabit Operativ të UNÇ dhe AP të Kosmetit, 5. I. 1945).

shin, madje, me pëlqimin e popullit, pra veprohej si edhe ndaj fajtorëve të tjerë.³⁵

Detyrë e rëndësishme dhe e përhershme që duhej të kryenin klerikët përkrahës të LNÇ-së ishte lufta e pandërprerë kundër propagandës dhe dezinformimeve të ndryshme që përhapnin shërbëtorët e ndryshëm të armikut. Gjatë vitit 1944, kur LNÇ në Kosovë kishte marr përmasa të luftës së përgjithshme popullore, nga nacionalistët dhe shovinistët e ndryshëm zgjedheshin parulla të ndryshme armiqësore, si: „Partizanët do t'i pushkatojnë të gjithë shqiptarët”.³⁶ Klerikët i kundërviheshin propagandës së tillë dhe porositnin popullin që të mbante qëndrim njerëzor ndaj bashkëvendasëve pa marrë parasysh përkatësinë fetare të tyre. Posaçërisht ata gjatë gjithë luftës këshillonin besimtarët myslimanë të Kosovës që të mos i fajësonin masat serbe, të cilat në të vërtetë nuk ishin fajtorë për pozitën e mëparshme të shqiptarëve, por ajo ishte rezultat i politikës së qeverive borgjeze që ishin më parë në pushtet.³⁷

Me masivizimin e LNÇ-së, si dhe me sukseset gjithnjë e më të mëdha të UNÇJ-së në Jugosllavi, pra edhe në Kosovë, ngushtohet fushëveprimi i armikut dhe i bashkëpunëtorëve të tij. Krahas kësaj shtohet ndikimi dhe numri i nëpunësve të BFI-së, të cilët vepronin për LNÇ-në. Pas çlirimit të Kosovës, nëpunësit e kësaj bashkësie fetare në pjesën më të madhe vazhduan punën e tyre profesionale e krahas saj edhe aktivitetin shoqëror nëpër këshilla nacionalçlirimtare të vendit etj.

Pas çlirimit të Jugosllavisë, në vitin 1946, me rastin e nxjerrjes së Kushtetutës së Parë të RFPJ-së u rregullua çështja në bazë të parimeve të njohura të marksizmit, pra u bë ndarja e kishës dhe e fesë nga shteti. Po ashtu, në Kushtetutën e tashme të RSFJ në nenin 174 të saj për Bashkësitë fetare thuhet: „Bashkësitë fetare janë të ndara nga shteti dhe gëzojnë të drejtën e kryerjes së punëve dhe të ceremonive fetare. Kjo ishte në pajtim me interesat e përgjithshme të shtetit të ri socialist dhe të popujve që jetojnë në të”.³⁸ Me kalimin e kohës marrëdhëniet ndërmjet BFI-së dhe shtetit u normalizuan.

³⁵ Si shënimi 32, 141.

³⁶ AKQ PKJ, sig. 588/1944, D. 4823.

³⁷ Si shën. 31.

³⁸ Todo Kurtović, *Politika SKJ i vjerske zajednice*, Sarajevo, 1977, f. 67.

L'ATTITUDE DE LA COMMUNAUTÉ RELIGIEUSE ISLAMIQUE
ENVERS LE MOUVEMENT NATIONAL LIBÉRAL EN KOSOVÉ
DE 1941 À 1945

R é s u m é

L'activité des communautés religieuses en Yougoslavie bourgeoise a été strictement liée avec le Pouvoir. La communauté religieuse islamique était égale avec toutes les autres communautés religieuses quoi qu'elle n'était pas privilégiée. Elle eut une attitude pro-gouvernementale.

Pendant la Deuxième guerre mondiale, la position et le statut des unités religieuses changea beaucoup, même plus tard reste le principe de l'alliance avec les autorités du Pouvoir. L'application des ordres fascistes et l'aide qu'elle offrait au gouvernement était une caractéristique de cette communauté religieuse jusqu'à la capitulation de l'Italie fasciste.

L'attitude du P.C.Y. envers la question religieuse et l'engagement des communistes de ces contrées permirent la différenciation parmi les employés dans cette communauté religieuse. Les cercles dirigeants de cette communauté, liaient avec l'ennemi l'intérêt matériel et spirituel c'est ainsi qu'ils continuèrent jusqu'à la capitulation, tandis que la majeure partie des employés du cadre inférieur de cette communauté faisaient les partisans de la lutte nationale libérale.

La situation ne change pas même après l'arrivée des Allemands - de ces nouveaux occupants, l'attitude de la communauté religieuse islamique était aussi pro-allemande. Malgré les mesures entreprises par l'ennemi afin de renforcer la position et l'influence de cette communauté dans les masses populaires, il n'arrive pas à atteindre le but.

Il n'y avait pas de grands changements concernant les sujets à l'intérieur de la communauté religieuse. Le nombre des employés religieux de la lutte nationale libérale de cette communauté était petit, mais leur influence aux croyants dans la religion islamiques était grande.

